



2022

RAPORT – TM2 -2022



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

www.hidroregjioni-jugor.com

PËRMBAJTJA

Zonat e përgjegjësish të K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”	4
---	---

I. RAPORTI I DEPARTAMENTIT TEKNIK	5
--	----------

1.1 Performancat	5
1.1.1 Situata e furnizimit – TM2 - 2022	5
1.1.2 Aktivitetet kryesore	5
1.1.3 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	9
1.1.4 Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	9
1.1.5 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	9

II. RAPORT I DEPARTAMENTIT RAJONAL PËR KONSUMATORË	10
---	-----------

2.1 Performancat	10
2.1.1 NJ.P- Prizren- TM2 - 2022	10
2.1.2 NJ.P- Suharekë- TM2 - 2022	11
2.1.3 NJ.P- Dragash- TM2 - 2022	12
2.1.4 NJ.P- Malishevë- TM2 - 2022	13
2.1.5 KRU- Hidroregjioni Jugor- TM2-2022	14
2.2 Komentet kryesore nga DPK- TM2 - 2022	15
2.2.1 Aktivitetet kryesore- TM2 - 2022	15
2.2.2 Raport i ankesave teknike dhe komerciale	15
2.2.3 Raport i Ekipes së inspektimit dhe shkyçjes	15
2.2.4 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	16
2.2.5 Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	16
2.2.6 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	16
2.2.7 Aktivitetet për zvoqlimin e UPF-se	17


III. RAPORT I DEPARTAMENTIT FINANCIARË	19
---	-----------

3.1 Aktivitetet kryesore – TM2 - 2022	19
3.2 Arsyeshmëria e shpenzimeve – TM2 - 2022	20
3.3 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	21
3.4 Masat e realizuara nga periudha paraprake	21
3.5 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	21
3.3 Transaksionet kryesore	21

IV.	RAP. I DEPARTAMENTIT ITUN	22
4.1	Fusheveprimtaria e ITUN	22
4.2	Aktivitetet kryesore	24
4.3	Masat e realizuara nga periudha paraprake	26
4.4	Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	27
4.5	Masat e realizuara nga periudha paraprake	27
V	Raport i Departamentit të Administratës	27
VI	Raport i Auditorit të brendshëm	35
VII	Raport i Zyrës së Prokurimit	36
	ORGANOGRAMI	38

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit,viti 2021



LEGJENDA:	
05	Zona e shërbimit
05	Qytetet me ujë
75	Fshatrat me ujë që menaxhohen nga HRJ
118	Venbanimet pa shërbime të ujësjellësit

Punoi: Shërbimi TEKNIK

I. RAPORT I DEPARTAMENTIT TEKNIK

1.1 PPERFORMANCAT- KRU „, HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A – PRIZREN

1.1.1 SITUATA E FURNIZIMIT – TM1- 2022

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijes për muajt Prill-Qershor të vitit 2022, në nivel regional, duke përfshirë të gjitha njësitë punuese e operuese, ka qenë i plotë dhe i rregullt. Gjendja e volitshme furnizuese është si rezultat i rritjes së natyrshme stinore të resurseve dhe kapaciteteve ujore sikurse dhe investimeve të vazhdueshme në pëmirësimin e rrjetit në përgjithësi me theks të veçantë në zonat problematike të furnizimit.

Në muajt Prill-Qershor, si rezultat i kushteve të volitshme klimatike dhe të kushteve tjera, në përgjithësi kemi realizuar furnizimin stabil, kuantitativ dhe kualitativ duke përmbushur standardet aplikative për furnizim 24h dhe cilësi 100 % të ujit të pijes dhe duke ndërmarrë në vazhdimësi aktivitetet e duhura në operim dhe mirëmbajtje për funksionim optimal të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

1.1.2 AKTIVITETET KRYESORE

- Angazhimet dhe menaxhimet e përditshme të puneve në perputhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e vendit të punës dhe jashtë tij për operim dhe funksionimit optimal të Departamentit Teknik dhe Kompanisë.
- Takimet e rregullta të menaxhmentit, me bashkëpunëtorët, me donatorë, me institucionet komunale, qeveritare, me konsumator etj.
- Shkëmbimet e shkresave përmes komunikimeve elektronike e fizike, harmonizimi i projekteve investive dhe dokumentacioneve perkatese teknike me të gjitha Institucionet financiare e tjera, perpilimi dhe finalizimi i projektpropozimeve te pergatitura nga DT. Në ekzekutim e sipër 3 marreveshje bashkëinvestuese me komunën e Prizrenit;
 1. Gypsjellësi Φ 400 mm në zonat e qytetit të Prizrenit,
 2. Rrjeti i ujësjellëst në zonën „Nënkalaja“ – Prizren,
 3. Gypsjellësi Φ 400 mm në Rr, „Ibrahim Rugova“ – Prizren,dhe 2 Marrëveshje bashkëinvesttuese të reja të lidhura me komunën e Prizrenit dhe Suharekës, brenda zonës menaxhuese te Kompanisë.
- Shqyrtimi dhe analizat profesionale te sistemeve elektropompuse dhe përgatitja e dokumentacionit teknik për prokurim per elektropompa, vegla pune dhe makineri e mekanizëm përcjellës. Vazhdimi i aktiviteve për aftësimin e njësisë së koagulimit dhe filtrimit të ujit të Lumbardhit në NJP- Prizren, Evidentimi i makinerisë dhe gjendjes së tyre në nivel të Kompanisë për klarifikimin e nevojave për investime të reja dhe asgjësimin e makinerisë jashtë përdorimit përkatësisht me amortizim të skaduar.
- Auditimet dhe evaluimet teknike me bashkepunetoret e DT te raporteve per institucionet kompetente dhe projekteve te paperfunduara, ato ne ekzekutim e siper, aplikacionet softwerike dhe menaxheriale, etj.
- Aplikimi dhe procedimi i shkresave zyrtare qe leshon DT - Pergjigjeve ne kerkesa, Dhënia e kushteve teknike, Lejeve, Vendimeve dhe Pelqimeve konform Rregulloreve te Kompanise.
- Mbështetja profesionale gjatë evaluimet të ofertave për programin - Faza V&VI: „Mënjanimi i ujërave të zeza në Europën Jugperëndimore“, për projektin; “Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në Prizren”, investuar nga KFW dhe Qeveria e Kosovës.

- Takimet finale përmbyllëse dhe kontributet direkte në finalizimin e kontratës investive rreth studimit të fisibiliteti për projektin “Implementimi i SCADA sistemit për kontroll, monitorim dhe automatizim të sistemit të ujesjellesit në të gjitha zonat menaxhuese të Kompanisë, implementuar nga “Korporata hungareze e teknologjike së ujit” – HWTC.
- Pjesëmarrja në Konferencën me karakter ndërkombëtar me titull “Energjizimi i sektorit të ujit në pellgun e Danubit”, mbajtur më 28-30 Qershor 2022, në Tiranë.
- Vazhdimi i kryerjes së detyrave të punës nga pozicioni paraprak në cilësinë e menaxherit të projekteve dhe menaxhimi i kontratave me Telekom, IPKO, KEDS e operator tjerë, evidentimi dhe procesimi për pagesë të shpenzimeve mujore energjetike e telekomunikuese, ofrimin e zgjidhjeve teknike, hartimin e paramasave e paralogarive, kujdesi për mbartëvajtjen operative të infrastrukturës fizike të njësive punuese të Kompanisë.

Aktivitet e departamentit teknik të ndermarra për eliminimin e humbjeve teknike.

- Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.
- Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – dedektimi i rrjetit të ujësjes dhe ndarja e zanave për dedektim.
- Ngritjen e vetëdijes të të gjithë konsumatorëve që ta paguajnë ujin në mënyrë që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do të kthehet konsumatorëve në shërbime dhe investime për shërbim sa më efikas të furnizimit me ujë të pijes.

Prodhimi i ujit m³ - TM2- 2022

Muaji	Prodhimi mujor m3	Prodhimi ditor- m3	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	2,987,000.00	32,824.18	379.9	
Suharekë	718,300.00	7,893.41	91.4	
Dragash	244,063.00	2,682.01	31.0	
Malishevë	372,577.00	4,094.25	47.4	
Total	4,321,940.00	47,493.85	549.7	

Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve TM2- 2022

Njësia Operative	Ujësjesi - uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	420	185	605
Suharekë	105	32	137
Dragash	17	05	22
Malishevë	95	25	120
Total	637	247	884

ZYRA PËR PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM – TM2 -2022

AKTIVITETET KRYESORE

- * Përpilimi i pëlqimeve, përgjigjeve në kërkesa për konsumatorët.
- * Takime me inxhinierat e njësive për pasurimin e GIS-it.
- * Përpilimi i projekt propozimeve nga HRJ (Projektet Investive Kapitale).
- * Takim në D.Sh.P – Prizren, Investimet Kapitale.

- * Përpilimi i Termave të Referencës për burimet në Jugperendim të Prizrenit (Vermica).
- * Takim pune në K.Malishevës për furnizim me ujë .
- * Plani i Monitorimit të cilësisë së ujit.
- * Plani i sigurisë së ujit.
- * Takim pune në zyre për legalizimin e konsumatoreve.
- * Menaxhimi i kontratave në sistemin e Prokurimit.
- * Vizita të rregullta në teren në kuadër të mbikqyrjeve.
- * Mbikqyrje në projektet e realizuara nga K.K Prizren: Rr.“De Rada”, “Nënkalaja” dhe “Φ400 mm”.
- * Mbikqyrje në projektet e Kompanisë: Rr.”Trepça”, Rr.”Alpet Shqiptare”, Rr.”Rexhep Kabashi” dhe “40 Burimet”.
- * Takim pune në Shqipri në kuadër të platformës Bechmarking (SHUKOS-SHUKALB).
- * Raporti i Përformancës për vitin 2021 të kërkuar nga K.Prizren.
- * Takim pune në zyret e ITUN, për Platformen “MIA”.
- * Marrje pjesë në konferencën në Tiranë të organizuar nga IAWD dhe Nexus - Shqipri.
- * Dalja në teren për leximin, verifikimin e ujëmatësave të prodhimit për një pasqyrim detal të ujëmatësave nëpër njesitë përkatëse (Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragash).
- * Takim pune në K.Komunal për realizimin e projekteve të përbashkëta dhe atë që janë në plan nga K.Komunal si dhe mundësia e vazhdimi i bashkëpunimit ndërmjet dy insitucioneve.
- * Matje gjeodezike dhe aktivitete të ndryshme profesionale për nevojat e kompanisë.
- * Gjatë muajve Prill-Qershor grupi ka vazhduar me përpunimin e të dhënave të terrenit, vendosjen e të dhënave në GIS.
- * Grupi i riparimit dhe kalibrimit të ujëmatësave në muajt Prill-Qershor, kanë arritur që gjithsej të bëjnë: 276 riparime të ujëmatësave dhe 1 ekspertizë. Ekziston raporti i veçant.
- * Në muajt Prill-Qershor, grupi i terrenit demontim – montim me njësi në Prizren kanë bërë gjithsej: 455 vizita të konsumatorit, 288 ndërrime të ujëmatësave, 98 riparime të defekteve si dhe leximin e ujëmatësave. Ekziston raporti i veçant.
- * Grupi i detektimit të rrjetit të ujësjellësit gjatë muajve Prill-Qershor, ka bërë gjithësej 186 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 149 defekte, ekziston raporti i veçant. Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 3,610 m.
- * Leximi i ujëmatësave zonal për muajt Prill-Qershor.
- * Bllombim të ujëmatësave

	Prizren Total –Gjithsej	Total
1	Bllombim-Kontrata	298
2	Ribllombim	05
3	Dera Mbyllur	684
4	Kërkes nga konsumatori	39
5	Zevendesim	27

RAPORTI PËR CILËSINË E UJIT- TM2-2022

Aktivitetet

Kontrolli permanent i prezencës së klorit residual në kroje në qytet si dhe kontrollimi i klorit në fshatra.
 Kontrolli permanent i kualitetit të ujit në burime si dhe sasinë e cila shfrytëzohet.
 Kontrolli i rregullt i stacioneve të klorifikimit mbi mbarvajtjen e procesit dhe paisjeve.
 Marrja e mostrave sipas planit të monitorimit.

Furnizim i stacioneve të klorifikimit me Hipoklorit të Natriumit në të gjitha fshatrat.

Riparuar injektorin në stacionin e klorinimit në „40-Burime” konkretisht në Ø 600, Ø 350 dhe pastruar ambientin i cili ishte mbushur me ujë si pasojë e defektit në injektor.

Riparuar sistemin e klorinimit në „Sozi” Injektorin si dhe sistemin e komunikimit të sasis së klorit në rrjet me sondë.

Riparuar injektorin në stacionin e klorinimit në Ø400 në stacionin e klorinimit në „Bunar-1” si dhe vakumrregullatorin.

Si detyrë nga DAK, kishim kryerjen e „Mostrës krahasuese” në mes laboratorëve të akredituar të cilën e kemi kry me sukses me laboratorin „Sara dhe Meti” si dhe laboratorin e kompanis së ujit të pijes „DEA”.

Takim pune në Prishtinë për hartimin e planit të monitorimit për cilësi të ujit.

Jemi angazhu në riparimin e pjesëve të ndryshme në koagulator me qëllim bërjen gati për futjen e tij në funksion kur të paraqitet nevoja.

Së bashku me puntorët e firmës „Diamanti” dhe ingjnierin e tyre ishim për ti futurë në funksion sistemin e klorinimit në Vërmicë.

Analizat Bakteriologjike, TM2- 2022

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave		Nr. i mostrave qe nuk pergjigjen	
		Bakteriologjike	Kimike	Bakteriologjike	Kimike
Prizren	Burim	16	16	9	0
	Ujësullës	23	23	1(munges klori)	0
Suharekë	Burim	6	6	4	0
	Ujësullës	11	11	0	0
Dragash	Burim	6	6	4	0
	Ujësullës	6	6	0	0
Malishevë	Burim	6	6	5	0
	Ujësullës	12	12	0	0
Totali- Ujësullës		104		1	0

Vrejtje: 1) Në burim, uji i patrajtuar ; 2) Ujësullës, uji i trajtuar

Analizat Bakteriologjike, ISHP-Prizren, TM2- 2022

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	10	0
	Ujësullës	216	0
Suharekë	Burim	2	0
	Ujësullës	32	2
Dragash	Burim	2	0
	Ujësullës	14	0
Malishevë	Burim	0	0
	Ujësullës	27	0
Totali- Ujësullës		289	2

Vrejtje: Numri i analizave të mostrave bakteriologjike të marrura në rrjetin e ujësullësit është 289 mostra dhe të gjitha mostrat i përgjigjen standarteve të ISHP.

1.1.3 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Keqpërdorimi i ujit të pijes.
- Ndërprerja e herë pas hershme e energjisë elektrike.
- Shpenzimet e mëdha të energjisë elektrike.

1.1.4 MASAT E REALIZUARA / MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Te gjitha defektet ne sistem te ujësjellësit dhe kanalizimit janë sanuar me kohe,
- Është përcjell ne mënyrë permanente cilësia e ujit te pijes ne nivel regjional,
- Është përgatitur dhe miratuar strategjia e UPF-se.

1.1.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

- Monitorimi i furnizimit me ujë te pijes ne gjithë zonën e shërbimit,
- Monitorimi i cilësisë se ujit te pijes ne nivel regjional,
- Vazhdimi i analizës se rrjetit te ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe bartja e te dhënave ne GIS,
- Fillimi i implementimit te strategjisë për uljen e UPF-se.

*Aktivitet e shërbimit teknik të ndermarrura për eliminimin e humbjeve teknike.

- ✚ Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit të vjeter të qytetit për eleminimin e humbjeve teknike – dedektimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndarja e zanave për dedektim.
- ✚ Ngritjen e vetëdijes të të gjithë konsumatoreve që ta paguajn ujin në menyre që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatoreve në sherbime dhe investime për sherbim sa me efikas të furnizimit me ujë të pijes.

II. RAPORT NGA DEPARTAMENTI PËR KONSUMATORË

2.1 PERFORMANCAT

2.1.1 RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE TM1- TM2 - 2022

2.1.1 NJËSIA PUNUESE - PRIZREN

MUAJI	TM1-2022	TM2-2022	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	2,440,100	2,987,000	546,900	22.41
<i>Faturimi m3</i>	1,247,326	1,461,947	214,621	17.21
<i>Faturimi nga uji €</i>	852,054.99 €	974,007.57 €	121,952.58 €	14.31
<i>Faturimi- te tjera €</i>	11,268.94 €	8,679.58 €	- 2,589.36 €	-22.98
<i>Faturimi Total €</i>	863,323.93 €	982,687	119,363.22 €	13.83
<i>Inkasimi nga uji €</i>	885,529.08 €	914,731.95 €	29,202.87 €	3.30
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	7,261.31 €	9,483.06 €	2,221.75 €	30.60
<i>Inkasimi Total €</i>	892,790.39 €	924,215	31,424.62 €	3.52
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	37,974	38,348	374	0.98
<i>% e inkasimit</i>	103.93	93.91	-10.01	-9.64
<i>Shpenzimet</i>	739,212.29 €	738,812.64 €	- 399.65 €	-0.05
<i>Pagat</i>	449,016.93 €	448,668.48 €	- 348.45 €	-0.08
<i>Rryma elektrike</i>	178,451.82 €	158,557.17 €	- 19,894.65 €	-11.15
<i>Shpe. e derivateveve</i>	26,038.70 €	22,464.41 €	- 3,574.29 €	-13.73
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	26,641.84 €	22,737.31 €	- 3,904.53 €	-14.66
<i>Miremb, e automjeteve</i>	5,307.57 €	8,407.30 €	3,099.73 €	58.40
<i>Shpen. E taksave</i>	25,402.55 €	19,554.07 €	- 5,848.48 €	-23.02
<i>Kemikalet</i>	- €	7,685.28 €	7,685.28 €	#DIV/0!
<i>Shpenzimet tjera</i>	28,352.88 €	50,738.62 €	22,385.74 €	78.95
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	1,192,774	1,525,053	332,279	27.86
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	48.88	51.06	2.17	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.21	1.25	0.04	
	208,286.31 €	185,402.37 €		

2.1.2 RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE
TM1- TM2 - 2022

2.1.2 NJËSIA PUNUESE - SUHAREKË

MUAJI	TM1-2022	TM2-2022	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	616,252	718,300	102,048	16.56
<i>Faturimi m3</i>	268,890	324,641	55,751	20.73
<i>Faturimi nga uji €</i>	180,827.13 €	212,096.06 €	31,268.93 €	17.29
<i>Faturimi- te tjera €</i>	1,468.00 €	470.00 €	- 998.00 €	-67.98
<i>Faturimi Total €</i>	182,295.13 €	212,566	30,270.93 €	16.61
<i>Inkasimi nga uji €</i>	134,632.67 €	124,366.17 €	- 10,266.50 €	-7.63
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	1,277.10 €	558.35 €	- 718.75 €	-56.28
<i>Inkasimi Total €</i>	135,909.77 €	124,925	- 10,985.25 €	-8.08
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	9,472	9,602	130	1.37
<i>% e inkasimit</i>	74.45	58.64	-15.82	-21.24
<i>Shpenzimet</i>	113,252.64 €	117,008.07 €	3,755.43 €	3.32
<i>Pagat</i>	64,443.09 €	67,730.38 €	3,287.29 €	5.10
<i>Rryma elektrike</i>	37,798.31 €	37,091.36 €	- 706.95 €	-1.87
<i>Shpe. e derivateveve</i>	2,354.89 €	3,117.62 €	762.73 €	32.39
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	5,778.31 €	6,134.75 €	356.44 €	6.17
<i>Miremb, e automjeteve</i>	1,115.68 €	1,115.84 €	0.16 €	0.01
<i>Shpen. E taksave</i>	573.00 €	- €	- 573.00 €	-100.00
<i>Kemikalet</i>	607.62 €	- €	- 607.62 €	-100.00
<i>Shpenzimet tjera</i>	581.74 €	1,818.12 €	1,236.38 €	212.53
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	347,362	393,659	46,297	13.33
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	56.37	54.80	(1.56)	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.20	1.07	(0.13)	
	24,041.90 €	7,916.45 €		

2.1.3 RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE TM1- TM2 - 2022

2.1.3 NJËSIA PUNUESE - DRAGASH

MUAJI	TM1-2022	TM2-2022	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	255,294	244,063	(11,231)	-4.40
<i>Faturimi m3</i>	31,023	52,888	21,865	70.48
<i>Faturimi nga uji €</i>	23,403.56 €	33,462.78 €	10,059.22 €	42.98
<i>Faturimi- te tjera €</i>	305.00 €	1,150.00 €	845.00 €	277.05
<i>Faturimi Total €</i>	23,708.56 €	34,613	10,904.22 €	45.99
<i>Inkasimi nga uji €</i>	22,421.08 €	26,534.94 €	4,113.86 €	18.35
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	110.00 €	1,130.00 €	1,020.00 €	927.27
<i>Inkasimi Total €</i>	22,531.08 €	27,665	5,133.86 €	22.79
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	1,591	1,606	15	0.94
<i>% e inkasimit</i>	95.80	79.30	-16.51	-17.23
<i>Shpenzimet</i>	30,213.14 €	30,533.82 €	320.68 €	1.06
<i>Pagat</i>	26,914.39 €	27,170.32 €	255.93 €	0.95
<i>Rryma elektrike</i>	1,839.33 €	1,018.23 €	- 821.10 €	-44.64
<i>Shpe. e derivateveve</i>	171.00 €	258.80 €	87.80 €	51.35
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	386.97 €	1,495.21 €	1,108.24 €	286.39
<i>Miremb, e automjeteve</i>	474.21 €	162.00 €	- 312.21 €	-65.84
<i>Shpen. E taksave</i>	234.86 €	- €	- 234.86 €	-100.00
<i>Kemikalet</i>	- €	- €	- €	#DIV/0!
<i>Shpenzimet tjera</i>	192.38 €	429.26 €	236.88 €	123.13
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	224,271	191,175	(33,096)	-14.76
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	87.85	78.33	(9.52)	
<i>Mbulimi operativ</i>	0.75	0.91	0.16	

- 1,370.90 € - 2,868.88 €

2.1.4 RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE

TM1- TM2 - 2022

2.1.4 NJËSIA PUNUESE - MALISHEVË

MUAJI	TM1-2022	TM2-2022	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	328,179	372,577	44,398	13.53
<i>Faturimi m3</i>	123,619	158,921	35,302	28.56
<i>Faturimi nga uji €</i>	89,631.98 €	109,937.40 €	20,305.42 €	22.65
<i>Faturimi- te tjera €</i>	8,423.00 €	3,953.00 €	- 4,470.00 €	-53.07
<i>Faturimi Total €</i>	98,054.98 €	113,890	15,835.42 €	16.15
<i>Inkasimi nga uji €</i>	84,895.64 €	90,501.15 €	5,605.51 €	6.60
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	10,296.00 €	6,397.00 €	- 3,899.00 €	-37.87
<i>Inkasimi Total €</i>	95,191.64 €	96,898	1,706.51 €	1.79
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	5,606	5,870	264	4.71
<i>% e inkasimit</i>	94.72	82.32	-12.40	-13.09
<i>Shpenzimet</i>	94,849.89 €	96,531.85 €	1,681.96 €	1.77
<i>Pagat</i>	55,206.11 €	53,116.63 €	- 2,089.48 €	-3.78
<i>Rryma elektrike</i>	29,629.21 €	33,208.05 €	3,578.84 €	12.08
<i>Shpe. e derivateveve</i>	2,042.64 €	2,662.12 €	619.48 €	30.33
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	2,699.16 €	3,877.97 €	1,178.81 €	43.67
<i>Miremb, e automjeteve</i>	3,134.22 €	1,815.53 €	- 1,318.69 €	-42.07
<i>Shpen. E taksave</i>	806.61 €	59.61 €	- 747.00 €	-92.61
<i>Kemikalet</i>	662.04 €	940.73 €	278.69 €	42.10
<i>Shpenzimet tjera</i>	669.90 €	851.21 €	181.31 €	27.06
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	204,560	213,656	9,096	4.45
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	62.33	57.35	(4.99)	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.00	1.00	0.00	
	8,785.00 €	366.30 €		

2.1.5 RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE
TM1- TM2 - 2022

2.1.5 HIDROREGJIONI JUGOR

MUAJI	TM1-2022	TM2-2022	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	3,639,825	4,321,940	682,115	18.74
<i>Prodhimi - l/sec</i>	473	550	76	16.13
<i>Faturimi m3</i>	1,670,858	1,998,397	327,539	19.60
<i>Faturimi l/sec</i>	210	254	44	20.92
<i>Faturimi nga uji €</i>	1,145,917.66 €	1,329,503.81 €	183,586.15 €	16.02
<i>Faturimi- te tjera €</i>	21,464.94 €	14,252.58 €	- 7,212.36 €	(33.60)
<i>Faturimi Total €</i>	1,167,382.60 €	1,343,756.39 €	176,373.79 €	15.11
<i>Inkasimi nga uji €</i>	1,127,478.47 €	1,156,134.21 €	28,655.74 €	2.54
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	18,944.41 €	17,568.41 €	- 1,376.00 €	(7.26)
<i>Inkasimi Total €</i>	1,146,422.88 €	1,173,702.62 €	27,279.74 €	2.38
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	54,643	55,426	783	1.43
<i>% e inkasimit</i>	98.39	86.96	(11.43)	(11.62)
<i>Shpenzimet</i>	977,527.96 €	982,886.38 €	5,358.42 €	0.55
<i>Pagat</i>	595,580.52 €	596,685.81 €	1,105.29 €	0.19
<i>Rryma elektrike</i>	247,718.67 €	229,874.81 €	- 17,843.86 €	(7.20)
<i>Shpe. e derivateveve</i>	30,607.23 €	28,502.95 €	- 2,104.28 €	(6.88)
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	35,506.28 €	34,245.24 €	- 1,261.04 €	(3.55)
<i>Miremb, e automjeteve</i>	10,031.68 €	11,500.67 €	1,468.99 €	14.64
<i>Shpen. E taksave</i>	27,017.02 €	19,613.68 €	- 7,403.34 €	(27.40)
<i>Kemikalet</i>	1,269.66 €	8,626.01 €	7,356.35 €	579.40
<i>Shpenzimet tjera</i>	29,796.90 €	53,837.21 €	24,040.31 €	80.68
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	1,968,967	2,323,543	354,576	18.01
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	54.10	53.76	(0.33)	
<i>Uji I pafaturuar l/sec</i>	263.14	295.53	32.38	12.31
<i>Mbulimi operativ</i>	1.17	1.19	0.02	
	168,894.92 €	190,816.24 €		

2.2 KOMENTET NGA DEPARTAMENTI PËR KONSUMATORË

2.2.1 AKTIVITETET KRYESORE

- Kemi nje faturim më të lartë në krahasim me TM paraprak, si rezultat i rritjes së konsumit dhe përmirsimit të gjendjes në burimet e ujit.
- Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellsit mbrenda afatit ligjor te secili konsumatorë.
- Janë vizituar nga lexuesit të gjithë konsumatorët në pronat e tyre ku është kërkuar inkasimi i mjeteve për shërbimet e ujësjellsit.

2.2.2 ANKESAT TEKNIKE DHE KOMERCIALE

- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike ndërsa ankesat komerciale të konsumatorëve janë shqyrtuar sipas prioritetit të tyre.
- Janë shqyrtu ankesat teknike dhe komerciale në nivel rajonal:

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	646
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	646
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	158
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	158
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	158

2.2.3 RAPORT NGA EKIPET E INSPEKTIMIT

- Kanë vazhduar kontrollet në teren te konsumatorët nga ekipi i inspektimit dhe verifikimet tek konsumatorët dhe aktivitetet janë te prezantuar ne tabelën e mëposhtme:

KRU"Hidroregjioni Jugor" sha

PERIUDHA RAPORTUESE : TM2 - 2022

Njësitë operative	Shpërndarja e njoftimeve paralajmëruese për përbarim	Konsumat orët e legalizuar	Lidhjet e paligjshme te zbuluara	Nr. i shkyçjeve	Verifikimi i leximit te ujëmatësve	Nr. i leximeve te gabuara	Rastet e dorëzuara për gjykatë	Vizita nga ankesat/kërkesat konsumatorëve	Shuma e inkasuar nga borxhet e vjetra
Prizren	1,312	399	11	11	3,429	28	7	68	87,451.15
Suharekë	201	40	13	0	1,766	0	0	32	16,590.00
Malishevë	108	180	20	10	67	18	0	22	13,645.00
Dragash	0	7	15	15	90	0	0	1	0.00
TOTAL	1,621	626	59	36	5,352	46	7	123	117,686.15

2.2.4 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Mos kontimi i disa ujëmatësve si rezultat i amortizimit të tyre apo arsyeve teknike tjera
- Mos pagesa e obligimeve nga institucionet dhe një pjese te borxheve te kontraktuara nga një pjese e madhe e konsumatorëve të cilët kanë nënshkruar kontratë për pagesën e borxheve me këste si rezultat i pamundësisë dhe rënies së fuqisë financiare te familjet e tyre nga Covid 19.
- Moszgjidhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpuara që nga pas lufta, pronat që kanë qenë nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Pronës, bizneset qe kanë falimentuar.

2.2.5 MASAT E REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Kemi një rritje të numrit të konsumatorëve si rezultat i pëlqimeve për kyçje dhe legalizimeve.
- Aktivitete me përmbarues privat (dalja ne teren me ekipet e kontrollës, identifikimi i adresave, identifikim i konsumatorëve, trashëgimtarëve të tyre etj.), janë ndërprerë gjatë kësaj periudhe.
- Janë shpërnda njoftime para inicimit të procedurës përmbarimore në terrenet e inkasantëve në qytet.
- Janë vizituar konsumatorët të cilët kanë ngec në pagesën e kësteve nga kontratat për pagesën e borxhit me këste, mirëpo te kjo kategori janë dërguar mesazhe përmes telefonit ku është kërkuar pagesa kësteve të papaguara dhe obligimeve rrjedhëse.

2.2.6 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

- Vazhdimi i dërgimit të rasteve në përmbarim
- Vazhdimësi e thirrjeve me telefon dhe dërgimi i mesazheve përmes telefonit te konsumatorët të cilët nuk i përmbahen kontratës.
- Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në teren, shpërndarja e paralajmërimeve para inicimit të rasteve te përmbaruesi duke i ndërruar terrenet e inkasantëve.
- Vizita më të shpeshta te konsumatorët e bizneseve të cilët kanë borxhe, ata të cilët kanë bërë kontratë e të cilët nuk i përmbahen pagesës së kësteve.
- Vazhdimësia e mbështetjes së inkasantëve nga ekipi i kontrollës te konsumatorët të cilët në vijimësi nuk paguajnë faturat.
- Mbikëqyrja dhe monitorim i vazhdueshëm i inkasantëve në arritjen e limiteve në inkasim
- Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që dëshirojnë të kyçen në shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit.

2.2.7 AKTIVITETET PËR ULJEN E UPF-së

MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË PËR ZVOGËLIMIN E UJIT TË PAFATURUAR

Raporti për Progresin e Arritur

KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A

Periudha Raportuese: **Prill-Qershor 2022**

1. Emri dhe mbiemri i Koordinatorit/Personit të ngarkuar për koordinimin e aktiviteteve për zbatimin e Strategjisë:	Besar Grazhda
2. Sa ishte shkalla e UPF për vitin 2021 (%):	54.40 %
3. Cili është caku i planifikuar për zvogëlimin e UPF për vitin 2022 (%):	51.95 %
4. Rezultatet e realizuara në 3-mujorin e parë të vitit 2022 (%):	
1) Janar : 53.90 % ; 2) Shkurt : 54.00 % ; 3) Mars : 54.40 % ; 4) Prill : 53.90 % ; 5) Maj : 53.75 % ; 6) Qershor : 53.65 % ; mesatarja 3-mujore: 53.76 %	
5. Kapacitetet organizative të Kompanisë të angazhuara për zbatimin e Strategjisë:	
5.1 Numri i ekipeve të kontrollit secilën prej njësive operative:	8 Ekipe në nivel të regjionit
5.2 Numri i ekipeve të shkyçjes për secilën njësi operative:	Secili ekip ka autorizim dhe të shkyçjes së konsumatorëve
5.3 Sa shpesh mbahen takimet e menaxhmentit për monitorim dhe koordinim të aktiviteteve për zvogëlimin e UPF?	Dy herë në muaj
5.4 Aktivitete tjera (të përshkruhen)	<ul style="list-style-type: none"> • Janë evidentuar numri i sakte i konsumatorëve pa konsum (edhe sipas Njësive punuese) • Janë duke u inspektuar të gjithë këta konsumatorë
6.1 identifikimi dhe shkyçja e konsumatorëve problematik (ilegal apo që vjedhin uj); (sa konsumatorë janë shkyçur gjatë periudhës raportuese për shkak të kycjes ilegale/vjedhjes së ujit? – te mos përfshihen shkyçjet për mospagesë të faturave)	
	<ul style="list-style-type: none"> • Lidhjet e paligjshme: 41 • Konsumatorë të legalizuar: 628 • Verifikimi i ujëmatësve: 5,845 • Nr. i leximeve të gabuara: 35 • Vizitat sipas ankesave: 182

<p>6.2 identifikimi dhe procedimi penal i konsumatorëve problematik (ilegal apo që vjedhin ujin):</p> <p>(sa konsumatorë janë proceduar penalisht për veprime të sanksionuara me Kodin Penal, si: vjedhja e manipulimi me ujëmatës, manipulimi i pllombës etj.).</p>	<p>Raste te dorëzuara ne gjykatë: 23</p>
<p>6.3 identifikimi dhe zëvendësimi i ujëmatësve jofunksional</p> <p>(sa ujëmatësja janë zëvendësuar gjatë periudhës raportuese?)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ekipet e kompanise gjate kesaj periudhe ne nivel regjional, gjithesej kane zevendesuar (ndrruar) 340-ujmatesa, te konsumatoret që ujematesit kanë qene jashtë funksionit (defekt).
<p>6.4 instalimi i ujëmatësve te konsumatorët që nuk kanë ujëmatës</p> <p>(sa ujëmatësja janë instaluar gjatë periudhës raportuese?)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ekipet e kompanise gjate kesaj periudhe ne nivel regjional, gjithesej kane instaluar 628-ujmatesa, te konsumatoret qe nuk kane pasur ujematesa.
<p>6.5 riparimi i rrjedhjeve</p> <p>(sa është numri i rrjedhjeve të riparuar?)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i rrjedhjeve te riparuar ne nivel regjional 637 riparime në sistemin e ujesjellesit
<p>6.6 zëvendësim i rrjetit të vjetërsuar</p> <p>(sa është gjatësia e rrjetit të zëvendësuar)</p>	<p>Zevendesimi i rrjetit te vjetersuar dhe zgjerimi i zones se sherbimit, jane instaluar gypa te PE-100 :</p> <ul style="list-style-type: none"> • DN 110=520m’ • DN 75=170m’ • DN 63=225m’ • DN 16÷40=390m’ <p>Shtirja e rrjetit te rri dhe zgjerimi i zones se sherbimit, jane instaluar gypa te PE-100 :</p> <ul style="list-style-type: none"> • DN 110=2,700.0m’(HRJ+KK.PZ) • DN 90=1,500.0m’
<p>6.7 aktivitete tjera - të përshkruhen (p.sh. formimi i DMA-ve, bllobimi/vulosja e ujëmatësve, menaxhimi i presioneve, kontrolli aktiv i rrjedhjeve etj.).</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Dedektimi i rrjeti te ujesjellesit ne nivel regjional me gjatesi L=3,610 m’, 186 raste per detektim ku jane gjetur 149 defekte. • Bazhdarime te ujematesve ne nivel regjional jane 276 riparime/bazhdarim te ujematesave. • Bllombime te ujematesave gjithsej 447 ujematesa poashtu edhe 5 ribllombime te ujematesave.
<p>7. Vështirësitë/problemet kryesore gjatë zbatimit të Strategjisë: (të përshkruhen)</p>	

III. RAPORT NGA DEPARTAMENTI I FINANCAVE

3.1 AKTIVITETET KRYESORE

Ky raport përfshinë disa aktivitete nga shërbimi financiar në pika të shkurtra, aktivitete të cilat janë në pajtim me rregulloren e punës së kompanisë si dhe ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga regjistrimet e rregullta dhe të drejta sipas ligjeve në Kosovë e deri te aktivitetet tjera për një përformacë sa më të mirë të kompanisë, dhe disa nga to janë:

- Kontrollimi dhe barazimi i të pagueshmeve dhe atyre të arkëtueshmeve,
- Përgatitja e raporteve mujore financiare, si inkasimin, të hyrat dhe ato të shpenzimeve, gjithashtu edhe raportet tremujore;
- Hapja dhe përgatitja e pagave për muajt përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrit të të punësuarve;
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amvisërisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, si dhe aprovimi i tyre për blerje;
- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;
- Pagesa e furnitorëve, pas kontrollimit të blerjeve; barazimi i të pagueshmeve;
- Plotësimin e librave të blerjes dhe shitjes sipas ligjeve dhe formës standarde të kërkuar nga ATK, për muajt përkatës, mujor e tremujor;
- Deklarimet e tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave etj., sipas ligjeve në fuqi;
- Raportimet tremujore ndaj ARRU-së
- Raportimet tremujore ndaj njësisë për ndërmarrjet publike;
- Raportimet tremujore ndaj Agjensisë së Statistikave të Kosovës;
- Pranimi i draft raportit dhe raportit final nga ZKA, për të cilin kemi kthyer komentet tona për të gjeturat e raportit;

3.2 ARSYESHMERIA E SHPENZIMEVE

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e II-të 2022, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të I-rë 2022, janë më të larta për një përqindje shumë të vogël.

Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsyet e rritjes apo uljes së tyre;

- Në pozicionin e pagave nuk kemi ndonjë ndryshim të madh të shpenzimeve, me një rritje fare të lehtë. Pra pagat edhe në këtë tremujor janë të njëjta me tremujorin e kaluar;

- Ndërsa tek pozicioni i energjisë elektrike kemi një rënie të shpenzimeve, në veçanti në njësinë e Prizrenit, për shkak se në këtë tremujor energjia elektrike nuk është përdorur për ngrohje në disa prej zyrave të kompanisë dhe kjo ka ndikuar edhe në ulje totale;
- Gjithashtu edhe te pozicioni i derivateve kemi një rënie të shpenzimeve, edhe pse është rritur çmimi i derivateve, gjë që ka ndikuar edhe në rritje të shpenzimeve, por në këtë tremujor, derivatet nuk janë përdorur për ngrohje qendrore dhe për këtë arsye edhe shpenzimet janë më të ulta;
- Edhe te pozicioni i mirëmbajtjes dhe riparimeve, dhe mirëmbajtjen e pompave, kemi një rënie të lehtë të kësaj kategorie të shpenzimeve, për shkak se në këtë tremujor ka pasur më pakë intervenime në mirëmbajtje se sa tremujori i kaluar;
- Por, rritje kemi pasur te pozicioni i mirëmbajtjes së automjeteve; në veçanti kemi rritje në Njësinë e Prizrenit, pasi që në këtë tremujor, pas përfundimit të sezonit dimëror, ka pasur më shumë për intervenime në makineri;
- Një rënie kemi tek shpenzimet e taksave, për shkak se në këtë tremujor, kemi më pak lëndë të dërguara tek përmbaruesi, ndërsa shpenzimet e anëtarësisë në SHUKOS edhe ato të ARRU-së mbetën të njëjta;
- Ndërsa te shpenzimet tjera, ku përfshihen shpenzimet e administratës, shpenzimet e telefonisë, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, shpenzimet e interesit, shpenzimet e trajnimit të stafit të kompanisë, shpenzimet e provizioneve etj., kemi rritje të kësaj kategorie, për shkak se në këtë tremujor, pas marrëveshjes me PCB, kemi bërë regjistrimin e shpenzimeve të provizioneve bankare, për periudhat e më hershme;

Pra si përfundim, shpenzimet totale, për këtë tremujor kanë qenë më të larta në krahasim me tremujorin e kaluar, për arsyt e cekura më lartë. Pra, pozicioni shpenzimeve tjera, konkretisht shpenzimet e provizionit, kanë ndikuar në rritjen totale të shpenzimeve operative;

3.3 PROBLEMET E HASURA GJATE KESAJ PERIUDHE

Duke e parë gjendjen financiare në KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A. Prizren, Kompania gjendet para tri problemeve të mëdha, respektivisht rreziqeve relativisht të mëdha:

- 1- **Vendimi i Gjykatës Themelore mbi borxhin e Kompanisë ndaj KEK**, për të cilin borxh në kemi arrit marrëveshje me KEK-un për përmbushjen e obligimit për 12 vite . Obligimi vjetorë është 120,768.00 euro
- 2- **Pamundësia e inkasimit të llogarive të arkëtueshme** të vjetërsuara , ekziston rreziku i parashkrimit të borxhit . Duke u bazuar në raportin financiar, kompania jonë ka kërkesa për llogari të arkëtueshme në shumë prej **12,238,984.00** euro
Këto llogari të arkëtueshme , ekziston rreziku që shuma dërmuese të jenë borxhe të këqija pasi që shuma prej 7,086,649.09 janë borxhe të provizuara .
- 3- **Detyrimet kontingjente -kërkesat e punëtorëve ndaj kompanisë** që kanë vendim gjykatë shuma 94,000.00 euro. Ekzistojnë edhe detyrime tjera kontingjente por që ende nuk kanë epilogë gjykatë.

3.4 MASAT E REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Kompania ka arrit të që gjatë këtij tremujorë shi të përmbush obligimin ndaj ATK-së
 - Hapat e ndërmarra: Kompania ka arrit marrëveshje për programimin e borxhit me KEK-un ,dhe atë që borxhi të paguhet për 144 këste mujore .Shuma e kështit është **10,064.00 euro**. Ne deri tani kemi arritur të përmbushim me sukses këtë marrëveshje .

3.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

- Të bëhen përpjekje të vazhdueshme që të kërkohet ndihmë edhe nga ana e Qeveris së Kosovës përkatësisht ME. për ndihmë financiare ne mënyrë që te përballohen këto probleme.
- Te bëhen përpjekje për inkasimin e llogarive të arkëtueshme para se ato të mundë të parashkruhen.

3.6 TRANSAKSIONET KRYESORE

10 pagesat me te medha ndaj Hidroregjioni Jugor per TM2
2022

Posting Date	Kons	Emri I konsumatorit	Banka	Kategoria	Shuma
17.05.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	13,234.04
17.05.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	8,822.14
07.04.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	8,629.54
11.05.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	7,834.02
14.04.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	7,025.65
29.04.2022	KONS-0029492	PTK drejtoria nr.1	NLB Banka	BIZNESE	5,247.31
21.05.2022	KONS-0016597	Jashar Keqeli	Vllesa	SHTEPI..Q	4,561.87
07.06.2022	KONS-0031865	"Naim Frasheri" Sh.Fillore Bajë	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	3,224.28
07.04.2022	KONS-0001555	Fatmir Kamberaj	ARKA-HASIME	SHTEPI..Q	2,952.65
07.06.2022	KONS-0031866	" 17 Shkurti " Sh.Fillore Bajë	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	2,856.75
				Totali	64,388.25

10 pagesat me te medha nga Hidroregjioni Jugor per Operatoret TM2 2022

NR.	DATA	BANKA	EMRI I KONSUMATORIT	SHUMA
1	4/8/2022	NLB-P-00025979	Profitech SH.P.K.	30,000.00
2	4/8/2022	PCB-P-00165462	MMPH - Departamenti i ujerave	26,043.01
3	4/15/2022	NLB-P-00026009	KEK - Bunari I	25,198.47
4	5/19/2022	BPBPZNPOS-003202	KEK - Bunari I	23,930.18
5	6/15/2022	BPBPZNPOS-003425	KEK - Bunari I	23,297.45
6	4/29/2022	NLB-P-00026123	Telekomi i Kosovës sh.a.	12,000.00
7	5/17/2022	NLB-P-00026197	Petrol Company fat.1950/22	9,867.97
8	4/6/2022	TEB-SH-000001455	KEK - Bunari I	9,410.65
9	5/4/2022	TEB-SH-000001514	KEK - Bunari I	9,410.65
10	6/3/2022	TEB-SH-000001574	KEK - Bunari I	9,410.65
				172,253.30

IV. RAPORT I DEPARTAMENTIT TE UN-ITUN

4.1 FUSHEVEPRIMI I DEPARTAMENTIT TE UN-ITUN

Departamenti i UN-ITUN ne fushe veprimtarinë e tijë përfshinë:

- Grumbullimin e ujerave te ndotura për qytetin e Prizrenit, Malishevës Suharekës dhe Dragashit përmes sistemeve ekzistuese dhe sistemeve te reja ne ndërtim e sipër,
 - Trajtimin e ujerave te ndotura përmes Impianteve për trajtimin e ujerave te ndotura te cilat janë ndërtuar, jane ne ndërtim e sipër dhe do te ndërtohen ne te ardhmen.
- Aktualisht është duke operuar me ITUN për qytetin e Prizrenit dhe jemi ne procedure te menaxhimit edhe me Impiantin e Bukoshit-Suhareke dhe Impiantin e Kukit-Dragash.
- Garantimin e parametrave te efluantit sipas direktivave dhe udhëzimeve ne fuçi te cilat përcaktojnë shkallen e ndotjes e cila lejohet te shkarkohet ne trupat pritëse.

SATATUSI I PROJEKTIT FAZA-1-

Ndërtimi i kolektorit kryesor dhe interceptoreve ne rruge, ana e djathte e rrjedhjes se lumbardhit

Ky projekt ka përfunduar ne vitin 2017, qe nga viti 2017 është ne funksion kolektori dhe 7 interceptoret te cilët shërbejnë për rregullimin hidraulik te kolektorit.

Raporti përfundimtar i kompletimit te projektit për fazën 1 do te dërgohet ne muajin Korrik pasi qe ka përfunduar komplet procedura e furnizimit me kamionin thithës shtytës, dhe si raport i kompletuar do te dorëzohet ne Departamentin e financave te kompanisë.

SATATUSI I PROJEKTIT TE ITUN-se FAZA-2-

Me qenese ende jemi ne fazën e pranim dorëzimit te projektit te impiantit ne Prizren, fillimisht po ju raportojmë per statusin e projektit te ITUN-se.

Projekti i ITUN-se për qytetin e Prizrenit është leshur ne operim ne Dhjetor te vitit 2019 dhe atë gjate fazës se testimave te cilat kanë qene pjese e kontratës dhe si te tilla kanë qene aktivite te realizuara nga kontraktori.

Kjo periudhe e testimave është ndare ne dy linja, ne linjën e ujit te ndotur dhe linjën e llumit, Testet për linjën e ujit kanë filluar ne dhjetor 2019 dhe kanë përfunduar me 24.06.2021, me çrast dhe është lëshuar certifikata e përkohshme marrjes përsipër nga Punëdhënësi dhe konsulenca, respektivisht nga Hidroregjioni dhe P2m Berlin&IDOM&Alb Architect.

Përgjatë kësaj periudhe deri me 24.06.2021, te gjitha shpenzimet operuse dhe te mirëmbajtjes kanë qene obligim i kontraktorit, pas kësaj date shpenzimet e operimit kanë kaluar tek punëdhënësi, konkretisht te Hidroregjioni Jugor. Periudha e DNP-se (Periudha e njoftimit te defekteve) për linjën e ujit ka filluar me 24.06.2021 dhe do te përfundoj me 24.06.2022, përmes këtij raporti ju njoftoj se DNP (periudha e njoftimit te defekteve) për linjën e ujit te ndotur ka përfunduar me date 24.06.2022, gjithmonë duke llogaritur se nuk ka linde ndonjë nevojë për zgjatje te kësaj periudhe te DNP-se edhe pse kontraktori AQUALIA deri me tani ka sanuar disa defekte te njoftuara përgjatë kësaj periudhe dhe është ne procedure te përfundimit te punëve te mbetura te cilat duhet ti realizoj-ti përfundoj maksimum deri me 04.10.2022 atëherë kur përfundon periudha e defekteve edhe për linjën e llumit. Ne forme tabelore me poshtë janë paraqitur njoftimet e defekteve përgjatë periudhës 24.06.2021 deri 24.06.2022 për linjën e ujit te ndotur te cilat janë sanuar nga kontraktori dhe te cilat eventualisht janë ne pritje për tu sanuar.

Kurse si pune te papërfunduara janë përfundimi dhe testimi i tre shtretërve te llumit, dhe furnizimi me material për objektin nr.57, deri me tani kanë mbetur pa u furnizuar vetëm materiali për konstruksionin e objektit ashtu siq është parapare ne kërkesën e dorëzuar nga konsonanca e projektit.

Testet e linjës se llumit kanë filluar ne Qershor-2021 dhe kanë përfunduar pjesërisht me date 04.10.2021 me çrast dhe është lëshuar certifikata e përkohshme e marrjes përsipër nga Punëdhënësi dhe konsulenca, respektivisht nga Hidroregjioni dhe P2m Berlin&IDOM&Alb Architect. Testet kanë përfunduar pjesërisht për shkak te mungesës se Llumit sepse ne këtë periudhe kohore uji i ndotur ne hyrje ka qene nen mesataren e ndotjes sipas parametrave te dizajnit, kontraktori dhe konsulenca detyrohen qe këto teste ti përfundojnë brenda periudhës se DNP-se.

Përgjatë kësaj periudhe deri me 04.10.2021, te gjitha shpenzimet operuese dhe te mirëmbajtjes kanë qene obligim i kontraktorit, pas kësaj date shpenzimet e operimit kanë kaluar tek punëdhënësi, konkretisht te Hidroregjioni Jugor. Periudha e DNP-se për linjën e Llumit ka filluar me 04.10.2021 dhe do te përfundoj me 04.10.2022, gjithmonë duke llogaritur se nuk do te linde ndonjë nevojë për zgjatje te kësaj periudhe te DNP-se.

Defektet te cilat janë paraqitur gjate kësaj periudhe nga ana jone dhe e konsulences dhe te cilat janë dhe do te duheshin te kryheshin nga ana e kontraktorit do te përshkruajmë si me poshtë për te dy linjat.

Për sa i përket testeve te mbetura te garancionit për linjën e llumit, ende jemi duke diskutuar me te dy konsulencat e projektit për përcaktimin e metodologjisë nga kontraktori se si munde te realizohen përfundimisht testet e garancionit për linjën e llumit.

Pas përfundimit te DNP-se (Periudhës se njoftimit te defekteve) për te dy linjat do te lëshohet raporti i kompletimit te projektit, ku do te nënkuptohet si pranim i përgjithshëm teknik.

Kontraktori me date 29.12.2021, lëshon një deklaratë për kompletimin projektit me të cilën pretendon për pagesë shtese duke ju referuar klejmit nr.15 dhe klejmit nr.16, nësi Departament menjëherë kemi reaguar ndaj kësaj deklarate dhe kemi kërkuar sqarim nga konsulencia e projektit e cila menjëherë e ka njoftuar KfW-ne dhe kontraktorin ku dhe përmes letrës zyrtare e ka njoftuar kontraktorin se nuk ka të drejtë për një pretendim të tillë.

Nësi departament rezervojmë faktin se kontraktori AQUALIA nuk do ta kërkojë këtë kompensim, prandaj edhe përmes raportit TM1 por edhe përmes këtij raporti TM2, ju njoftojmë se kjo çështje do të duhej të merret seriozisht nga menaxhmenti i kompanisë dhe të diskutohet edhe njëherë përmes një takimi të veçantë edhe me Konsulencën edhe me KfW-ne.

SATATUSI I PROJEKTIT MASAT SHOQERUESE-

Për sa i përket projektit të Masave Shoqëruese faza 2 e cila ka konsistuar në asistencën teknike pas le shuarjes në operim të ITUN-se, kjo periudhë ka qenë e planifikuar në kohëzgjatje prej 18 muajsh duke filluar në janar 2020 dhe do të përfundojë në qershor 2022.

Gjatë kësaj periudhë kjo konsulencë ka zhvilluar këto aktivitete të parapara në kontratë:

- Mbikëqyrja dhe verifikimi i punëve të përfunduara,
- Mbikëqyrje e procesit të trajnimit,
- Monitorimi dhe trajnimi i stafit të laboratorit,
- Analiza e SCADA-es dhe hartimi i raporteve të sajë,
- Digjitalizimi i planit të mirëmbajtjes përmes MMS,
- Mbikëqyrja dhe kërkesat për optimizimin e ITUN.

Kontrata me konsulencën e Masave Shoqëruese DORSCH GROUP ka përfunduar me 30.06.2022, mirëpo nuk janë shfrytëzuar shërbimet opsionale të cilat i ka parapare kontrata.

Me datë 16.06.2022 kemi dërguar kërkesë në KfW për vazhdimin e kontratës me konsulencën e Masave Shoqëruese si vijon:

Siç diskutuam me datë 23 Maj 2022, dëshirojmë të kërkojmë miratimin tuaj për vazhdimin e kontratës Konsulencën e Masave Shoqëruese.

Në të kundërt Kontrata do të përfundojë me 30 Qershor 2022.

Ky vazhdim do të mbulojë çështjet në vazhdim:

Optimizimi i operimit të WWTP, efikasitetin e energjisë dhe masat për kursimin e kostos.

Përvetësimi i softuerit të nevojshëm për përdorimin e të dhënave nga SCADA të cilat mundësojnë manovrimin me efikasitet të vegjël se implementuar për të dhënat historike në SCADA.

Trajnime të mëtutjeshme për operim me Laborator.

Vazhdimi do të jetë për 6 muaj (deri në fund të Dhjetorit 2022).

Akoma janë disa mjete të rimbursueshme dhe shërbime opsionale të mbetura në kontratën e Konsulencës (optional services 1 and 3) që do të shfrytëzohen për mbulimin e këtij adendumi.

Për më tepër, adendumi ka me formalizim tarifën e ndërprerjes në vlerë prej 8850 Euro për të cilën kemi pajtuar në emailin e datës 04.06.2021.

Ju lutem gjeni të bashkangjitur adendumin e përgatitur nga Dorsch në të cilën të gjitha pikat janë të përfshira për arsye sqarimi.

Ende jemi ne diskutime me KfW-ne për mundësinë e zgjatjes apo shfrytëzimit te shërbimeve opsionale qe parasheh kontrata me DORSCH GROUP.

Me date 08.06.2022 Jemi pajisur me certifikate te përdorimit nga ana e MMPH-se ku me kete rast do te njoftohen institucionet tjera te linjës si ARRU, ME, SHUKOS, MTI, etj.

Për sa i përket këtij raporti TM2 për statusin e projektit te ITUN-se, e kam paraqitur ne pika me kryesore, ndërkaq për me gjerësisht ekzistojnë raportet periodike dhe tremujore te përpiluara nga konsulenca e projektit dhe te cilat munde ti keni ne dispozicion ne çdo kohe.

AKTIVITETET KRYESORE-Prill-Qershor-2022

Menaxheri i Departamentit te UN-ITUN

- Angazhim dhe menaxhim i përditshëm i aktiviteteve qe kanë te bëjnë me operim, funksionim dhe optimizim të Departamentit ne përgjithësi e te ITUN-se ne veçanti,.
- Takimet e rregullta të menaxhmentit, takimet virtuale me donatore te huaj dhe vendor, me institucionet komunale, qeveritare, me konsumator, me konsulencat e projektit dhe me kontraktoret etj.
- Shkëmbimet e shkresave përmes komunikimeve elektronike e fizike, harmonizimi i aktiviteteve për ITUN-ne aktuale dhe projektet tjera potenciale te cilat munde te përfitohen ne te ardhmen ne këtë sektor.
- Përgatitja, monitorimi, analiza dhe plasimi i te dhënave teknike, financiare dhe administrative tek donatorët potencial si KfW, Qeveria e Kosovës. Komuna e Prizrenit, etj.
- Angazhimi si kryetar i komisionit për evaluimin e ofertave ne projektin Rehabilitimi i sistemit te kanalizimit ne qytetin e Prizrenit Faza V dhe VI,
- Prezenca e ekspertit nga DORASCH dhe aktivitet 5 ditore për optimizimin dhe laboratorin e ITUN-se,
- Prezenca e përfaqësuesit te AQUALIA-as Viktor Jeminez ne Impiant, ku diskutuam për procesin e punës se impiantit, testet e mbetura te linjës se llumit, punët e papërfunduara ne impiant si dhe sanimet e defekteve te njoftuara gjate periudhës se DNP-se,
- Prezenca e përfaqësuesit te konsulentit vendor ALB ARCHITECT, ne lidhje me përditësimin e punëve te papërfunduara dhe sanimit te defekteve te njoftuara brenda DNP-se,
- Marrja e certifikatës se përdorimit për ITUN nga MMPH,
- Monitorimi, analizimi dhe njoftimi i te gjitha problemeve ose defekteve ne operim dhe mirëmbajtje për gjate periudhës se defekteve,
- Analiza e ofertës se dërguar nga kompania Austriake për sa i përket protokolleve te SCADA,
- Monitorimi, krahasimi dhe aplikimi i testeve te analizave ne laboratorin e ITUN-se,
- Takime te rregullta mujore me stafin aktual te ITUN-se,
- Procedimi i kërkesave logjistike dhe atyre investive per nevojat e ITUN-se.
- Rregullimi i komplet dokumentacionit për sa i përket zhdoganimit dhe regjistrimit te pompës shtytëse dhe modifikimi i kamionit thithës shtytës.
- Pranimi përfundimtar dhe prova e kamionit thithës shtytës me kompaninë furnizuese TIMAK nga Shqipëria,
- Prezenca e përfaqësuesve nga IKSHP, per vaksinimin e stafit te punëtorëve ne mirëmbajtje te kanalizimit dhe punëtorëve te ITUN-se.
- Takim me përfaqësuesen nga Shqipëria ne lidhje me impiantet parciale,
- Prezenca e përfaqësuesit vendor te Masave shoqëruese për optimizimin dhe laboratorin e ITUN-se,

- Vizite ne teren me çrast është inspektuar komplet kolektori kryesor dhe interceptoret-kaperderdhesat ne aspektin e funksionimit.
- Takimet virtuale me te gjitha palët e interesit janë përshkruar ne tabelën si m poshtë.

Takimet virtuale Prill-Qershor 2022				
Data	Ora	Platforma	Tema	Pjesmarrësit
4/28/2022	10:00	Skype	Problemi me parametrat e fundit të rrjedhës	Lulzim Pacarizi Gunnar Demoulin Bujar Kokollari Lumni Sallahu
4/29/2022	10:00	Zoom	SDSW Kosovo, Ph2 - Ndarja e kosos së energjisë elektrike Aqualia	Lulzim Pacarizi Lumni Sallahu Dirk Fitzke Kadri Selimaj
5/12/2022	10:00	Zoom	Protokolet e SCADA	Lulzim Pacarizi Lumni Sallahu Gunnar Demoulin Dirk Fitzke Bujar Kokollari Joerg Strasser
5/23/2022	15:00	Webex	Çështjet në pritje me Aqualia dhe WWTP?	Georg Gruener Uwe Arras Premtim Islami Dirk Fitzke Lulzim Pacarizi Zenel Zenelaj Lumni Sallahu
6/20/2022	14:00	Zoom	1. Kompletimi i fazes 1 2. Kamioni thithes-shtytes 2. Testet e garancisë së llumit 3. Analizat e laboratorit, 4. Autosemlperi 6. Turbulira 7. Vazhdimi i DNP?	Lulzim Pacarizi Dirk Fitzke Gunnar Demoulin Lumni Sallahu Bujar Kokollari Kadri Selimaj

Operimi i ITUN-së për periudhën TM2/2022

Uji i trajtuar dhe Llumi i stabilizuar gjate TM2-2022

Trajtimi i ujit te ndotur m³ - Prill - Qershor, 2022

Muaji	Uji ne hyrje m3/muaj	Uji ricirkuluar- m3/muaj	Uji i trajtuar (m3/muaj)
Prill	326311	185185	338438
Maj	335821	133858	347066
Qershor	299800	91787	305637
Total	961962	410830	991141

Stabilizimi i llumit m³ - Prill - Qershor, 2022

Muaji	Llumi pompuar nga dekantuesi primar m3/muaj	Llumi pompuar nga dekantuesi sekondar- m3/muaj	Llumi i deponuar ne shtreter (m3/muaj)
Prill	1866	1738	310
Maj	2252	1651	342
Qershor	930	297	893
Total	5048	3686	1545

Mirëmbajtja e planifikuar sipas aplikacionit MMS – Prill - Qershor, 2022

Muaji	Trajtimi Mekanik	Trajtimi Biologjik	Trajtimi I Llumit
Prill	820	69	30
Maj	858	70	40
Qershor	541	75	46
Total	2219	214	116

Mirëmbajtja emergjente sipas aplikacionit MMS –/ Prill - Qershor, 2022

Muaji	Trajtimi Mekanik	Trajtimi Biologjik	Trajtimi I Llumit
Prill	7	2	0
Maj	9	3	0
Qershor	5	1	0
Total	21	6	0

Njoftimet e defekteve gjate DNP-se periudhas TM2 (Prill - Qershor), 2022

Muaji	Trajtimi Mekanik	Trajtimi Biologjik	Trajtimi I Llumit
Prill	3	0	0
Maj	2	0	0
Qershor	2	0	0
Total	7	0	0

Raporti mbi cilësinë e ujit në hyrje dhe në dalje të ITUN-se për TM2 nga Lab. i kompanisë

Aktivitetet tjera :

Duhet theksuar se laboratorit si sektor i ITUN-se është një ndër objektet shumë të rëndësishme të impiantit, l cili na mundëson që të arrijmë optimizimin sa më të mirë të ITUN-se, pasi që optimizimi i ITUN-se është në funksion të rezultateve që gjen eron laboratorit pas analizimit të mostrave si në hyrje, si pas dekantimit primar po ashtu edhe në dalje të ITUN-se, po ashtu funksionimi i mirë i laboratorit do të na mundësojë plotësimin e kriterëve ambient ale për sa i përket parametrave shkarkues të cilat lejohen të shkarkohen në trupat pritës siç është në rastin tone lumi Lumbardh.

Kapacitetet e laboratorit na mundësojnë ekzaminimin e mostrave të ujit të ndotur sipas kërkesave ligjore ambient ale dhe kemi kapacitet të tillë ku mund të planifikojmë ekzaminimin e të gjitha mostrave në nivel regional dhe me gjere.

Analizat, Prill – TM2- 2022 – Sipas UD 15-2008, MMPH

ITUN-Prizren

ITUN-Lokacioni	Lloji i ujit	Nr, i mostrave	I pergjigjet	Nuk i pergjigjet
Prizren	Hyrje	94	94	0
Prizren	Pas dekanatimit primar	3	3	0
Prizren	Ne dalje	90	81	9
Totali		187	178	9

ITUN-Bukosh, Suhareke

ITUN-Lokacioni	Lloji i ujit	Nr, i mostrave	I pergjigjet	Nuk i pergjigjet
Bukosh-Suhareke	Hyrje	0	0	0
Bukosh-Suhareke	Pas dekanatimit primar	0	0	0
Bukosh-Suhareke	Ne dalje	0	0	0
Totali		0	0	0

ITUN-KUK-Dragash

ITUN-Lokacioni	Lloji i ujit	Nr, i mostrave	I pergjigjet	Nuk i pergjigjet
Kuk-Dragash	Hyrje	0	0	0
Kuk-Dragash	Pas dekanatimit primar	0	0	0
Kuk-Dragash	Ne dalje	0	0	0
Totali		0	0	0

1.5.3 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Kemi probleme me furnizim te energjisë elektrike nga ana e KEDS,
- Mungese e stafit-(3 Roje, 1 punëtor fizik, 1 Punëtor mekanik, 1 Teknik te elektros dhe 1 mirëmbajtës).
- Me cilësinë e ujit ne dalje [nente (9) mostra janë jashtë standardeve],
Sipas raporteve dhe korrespondencave e po ashtu edhe nga mbikëqyrja e brendshme, konstatojmë se analizat e mostrave ne hyrje dhe ne dalje, konkretisht analiza e SHBO5 nuk është e saktë për shkak te biosenzoreve (jemi ende ne procedure te konstatojmë gjendjen e biosenzoreve).

1.5.4 MASAT E REALIZUARA / MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- E gjithë mirëmbajtja e planifikuar sipas MMS-it është realizuar ne afat te parapare,
- Te gjitha sanimet e defekteve emergjente janë sanuar me kohe,
- Te gjitha njoftimet e defekteve janë njoftuar brenda periudhës se parapare te defekteve.
- Janë zbatuar manualet si ne operim si ne mirëmbajtje po ashtu edhe ne mbrojtje dhe siguri ne pune.

1.5.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

- Monitorimi i sistemit te kanalizimit dhe pusetave kapërderdhëse,
- Monitorimi i fazave te trajtimit për një cikël sa me efikas,
- Monitorimi i cilësisë se ujit ne hyrje, pas dekantimit primar dhe ne dalje,
- Vazhdimi i aktiviteteve ne mirëmbajtjen e planifikuar sipas SOP Procedurave Standarde te Operimit
- Instalimi i kamerave për sigurimin e zonës se pare mbrojtëse,
- Efikasiteti ne aspektin logjistik, furnizim me kohe me kemikate për laborator,
- Efikasiteti ne aspektin logjistik, furnizimi me kohe me nafte dhe material fazonerik te nevojshëm për intervenime emergjente,
- Vazhdimësia e sigurisë dhe mbrojtjes ne pune për stafin e ITUN-se dhe ndaj stabilimenteve punuese te ITUN-se,
- Kompletimi i stafit te nevojshëm për efikasitetin e punës ne ITUN,
- Mirëmbajtje me efikase e hapësirës se ITUN-se pasi qe është sipërfaqe shume e madhe dhe nevojitet angazhim si ne fuqi punëtorë po ashtu edhe makinerike.
- Takimet me kryetaret e Komunave përkatëse ne lidhje me:
 - Konsolidimin e sistemeve egzistuese te kanalizimit dhe planifikimit te sistemeve te reja te kanalizimit.
 - Mundësia e marrjes ne menaxhim te Impiantit ne fshatin Kuk, komuna Dragashit dhe ne fshatin Bukosh, komuna e Suharekes,

- Mundësia e përpilimit të Master Planeve për zgjerimin e shërbimeve përmes sistemeve të raja të kanalizimit po ashtu edhe Impianteve për trajtimin e ujerave të ndotura për secilën Komunë ku ofrojmë shërbime përkatëse.

-Në javën e katërt të muajit Korrik kemi planifikuar vizite në Impiantin e Gjakovës dhe Pejes, për të shkëmbyer përvojat pasi që në krahasim me impiantin tona kanë teknologji të ndryshme për sa i përket procesit të trajtimit.

V RAPORT NGA DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV

Departamenti i administratës gjatë këtij tremujori është marruar me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

- Gjatë kësaj kohe janë përgatitur të gjitha Vendimet që kanë dalë nga takimet e rregullta të menaxhmentit të Kompanisë.
- Nga shërbimi juridik janë përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta në lëmin e veprimtarisë së Kompanisë.
- Nga zyra ligjore gjatë TM2 është bërë përfaqësimi i Kompanisë në Gjykatën Themelore të Prizrenit, Dragashit, Malishevës dhe Suharekës si dhe është punuar intensivisht në procedimin e lëndëve të përmbareshit privatë për secilën njësi punuese, lëndë këto që kanë të bëjnë me konsumatorët e amvisërisë dhe bizneset që kanë borbh ndaj shërbimeve të ujësjellësit.
- Pas vlerësimit të punës së punonjësve nga udhëheqësit e shërbimeve përkatëse janë vazhduar kontratat e punëtorëve të Kompanisë të cilët kanë qenë në kohë të caktuar.
- Është bërë mbikëqyrje dhe mirëmbajtje e duhur në azhurnimin e rregullt të ueb-faqes, siç parashihet me Ligj mbi NP, janë kryer të gjitha arkivimet, publikimet për autoritetin përkatës sipas ligjit.
- Gjithashtu ky shërbim ka lëshuar për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në punë, me vendim i është kompensuar punëtorëve pagesa e shpenzimeve të mjekimit nga lëndimi në punë gjatë orarit të punës.
- Janë përgatitur Vendime për mbikëqyrje dhe pranim teknik të punimeve për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga donacionet sipas kërkesës së shërbimit teknik.
- Janë nënshkruar marrëveshjet e reja për shërbime të ujësjellësit dhe ujerave të ndotura në mes të Komunës së Prizrenit, Suharekës, Malishevës, Dragashit, Mamushës dhe KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh. A.
- Aktvendimet për pushime vjetore janë lëshuar pas kërkesës me shkrim të punëtorëve dhe aprovimit apo pëlqimit nga udhëheqësit e tyre i drejtpërdrejtë.
- Në Departament të Administratës kemi pasur auditim nga Auditori i Zyrës Kombëtare të Auditimit, lënda e auditimit ka qenë mbarëvajtja e punës së Departamentit të administratës gjatë vitit 2021.
- Poashtu auditim kemi pasur edhe nga Auditori i Brendshëm lidhur me menaxhimin e procesit të rekrutimit në kompani për periudhën kohore 01-07/2021 dhe 01-04/2022.

- Pjesëmarrje në takime zyrtare me Përmbartuesit Privat, ku janë diskutuar problemet me të cilat ballafaqohemi gjatë punës.
- Është përfaqësuar Kompania në Gjykata ne nivel rajonal.
- Janë përgatitur Propozime për Përmbartim, Përgjigje në Prapësim, Konstatime, Autorizime, Padi, si dhe shkresa tjera të cilat i kemi adresuar tek institucionet e ndryshme.
- Është bërë regjistrimi ne programin Navision, i kontratave të punës së punonjësve, pushimet vjetore, mjekësore, pushimeve pa pagesë, pushimet për lindje te fëmijës, rastet e vdekjes së anëtarit te ngushtë të familjes.
- Po ashtu janë duke u regjistruar në program edhe vlerësimet e punës për vitin 2021 të punëtorëve ne K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh. A.
- Është dhënë përgjigje në kërkesës së Koordinatorës se QPS-së -komuna e Prizrenit, lidhur me mbledhjen e të dhënave në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2021. Të dhënat e kërkuara kanë qenë numri i përgjithshëm i punëtorëve ne kompani, numri i të punësuarve femra, personave me përgjegjësi të kufizuar, të punësuarit nga komunitet pakicë .
- Pjesëmarrja ne punëtorin e organizuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Environmental Consulting Team në Orion Conference Centre në Prishtinë me teme: Programi i ndërtimit të kapaciteteve mjedisore dhe sociale. Pjesëmarrës ishin menaxhmenti i lartë të ndërmarrjeve publike në sektorin e ujërave dhe mbeturinave për të siguruar angazhimin e tyre dhe angazhimin e stafit të tyre në proces..

Pushimet e shfrytëzuara nga punonjësit gjatë TM-2/2022

Nr	Llojet e pushimeve	Nr. i Punonjësve që kanë shfrytëzuar pushimet
1	Pushim vjetor	252
2	Pushim mjekësor	33
3	Pushim pa pagesë	5
6	Pushim të lehonisë	2
7	Lëndim ne pune	2
8	Pension	1
9	Pushim për rast vdekje	1

Ne baze te konkursit te shpallur me 18.01.2022 për pozitën e punës Lexues kane filluar pune katër punëtor ne njësinë punuese Prizren me pozite te punës Lexues me date 01.04.2022 dhe dy punëtorë lexues ne njësinë punuese Suhareke.

PERSONELI – PRILL – QERSHOR 2022

Muajt	Nr. i te punësuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Punë praktike
Prill	326	5		1	1
Maj	324		1		
Qersho r	322		1		

Punëtori i njësisë punuese Prizren O.Th me pozite te punës kanalizues, me datë 11.04.2022 ka vdekur dhe Kompania bazuar ne Rregulloren për paga , familjes së tij i është dhënë ndihmë solidare një pagë nga mesatarja e të ardhurave personale te të gjithë punëtorëve në kompani.

Ne baze te nenit 69, paragrafi 1 i Ligjit te punës Nr. 03/L-212, kanë shkëputur kontratën e punës me vet dëshirë një lexues dhe një ndihmës gjeodet të njësisë punuese të Prizrenit.

Punonjësi i njësisë punuese Dragash M.R me pozite te punës Vozitës i mjeteve të punës (MLT) – Rojtar, ka marr Vërejtje me goje me date 17.05.2022, në bazë të Nenit 86, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dhe Neni 6, Pika 1, të Rregullores mbi Përgjegjësin Disiplinore dhe Materiale,

NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: QERSHOR - 2022

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH. A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Mysliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	282	32	3	5	322
Numri i Punëtorëve në %	87.6	9.9	0.9	1.6	100

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	42	13.04	
MESHKUJ:	280	86.96	
TOTAL	322	100.00	

KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: QERSHOR 2022

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A								
KUALIFIKIMI								
Kualifikimi	Doktoraturë	Master	Fakultet	Bachelor	Sh. e mesme	Shkolla fillore	Pa kualif.	Gjith.
Nr. i punëtorëve	2	14	24	38	211	32	1	322
Kualifikimi në %	0.62	4.35	7.45	11.80	65.53	9.94	0.31	100.00

Raport i numrit te punëtorëve, Prill- Qershor – 2022

Nr.	Muaji	Hidroregjioni Jugor	Prizren			Suharekë	Dragash	Malishevë
			Prizren	ITUN	Total			
1	Prill	329	221	18	242	37	16	34
2	Maj	324	219	18	237	37	16	34
3	Qershor	322	217	18	235	37	16	34

PËRFAQËSIMI NË GJKATA PËR PERIUdhËN KOHORE PRILL – QERSHOR 2022

Muaji	Seanca përgatitore	Seanca kryesore	Seanca të shtyra	Ndërmjetësim	Vërejtje
Prill	/	1	/	1	/
Maj	/	1	1	2	/
Qershor	1	1	2	1	/
Totali	1	3	3	4	11

ARDHJET NGA GJKATA DHE INSTITUCIONET TJERA

	Prill	Maj	Qershor	Totali
Aktvendime me provime të pjesërishme	/	8	7	15
Aktvendime në favor të Kompanisë	1	4	3	8
Caktimi i përfaqësuesve të përkohshëm	1	4	1	6
Thirrje për seanca gjyqësore, ndërmjetësim etj.	3	/	1	4
Aktvendime E.nr.	1	/	/	1
Kallëzimet penale nga Kompania	/	2	21	23
Aktvendime për Kallëzime Penale në favor të Kompanisë	/	/	1	1
Përgjigje në Padi	/	1	/	1
Ankesa nga kompania	/	3	1	4
Përgjigje në Ankesë nga konsumatorët	/	/	1	1
Ankesë nga konsumatorët	/	1	2	3
Përgjigje në Ankesë të Konsumatorëve	/	1	/	1
Ekspertizë në dëm të Kompanisë	/	/	1	1
Konkluzione për njoftime të gjykatave	/	/	1	1
Urdhëresë për pagesë të Garancisë	/	/	/	/
Pagesë të Taksës Gjyqësore	/	/	1	1

LËNDËT TË CILAT JANË NË PROCEDURA GJYQËSORE DHE TË CILAT E KËRCËNOJNË KOMPANINË

Nr.	C.nr.	Kontesti	Vërejtje
1	C. nr. 116/03, datë 08.05.2013	Padi për kompensim dëmi.	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
2	C.nr. 286/14, datë 03.06.2015	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë

3	C.nr. 170/18, datë 14.09.2018	Padi – kompensim dëmi	Gjykata Themelore e Prizrenit me Aktgjykim e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe tani Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
4	C.nr. 471/2017, datë 06.10.2017	Padi – kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
5	C.nr. 416/18, datë 24.05.2018	Padi – Kontest pronësor	Gjykata Themelore e Prizrenit me Aktgjykim e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe tani Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
6	C.nr. 99/16, datë 06.03.2018	Padi – Kontest pronësorë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Dragash
7	C.nr. 364/16, datë 12.10.2016	Padi – Kontest pronësorë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë
8	C.nr. 745/05	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
	05.09.2005		
	C.nr. 68/17 (Nr. i ri)		
	08.10.2015		
9	C.nr.1902/2019	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
10	C.nr.251/20	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
11	C.nr. 1030/20 27.07.2020	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën E apelit në Prishtinë
12	CP.Nr. 1024/20 19.01.2021	Propozim për përmbarim	Në Gjykatën Themelore në Prizren
13	C.nr.363/20	Padi për anulim të Vendimit Nr.930/20	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë
14	C.nr.1714/19	Padi – kompensim dëmi material dhe jo- material	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
15	C.nr.504/19	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë

16	A.nr.1064/19	Padi për anulim të Vendimit Nr.2707/18	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ.
17	C.nr.239/18	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren

Paditë e ushtruara nga Kompania

1	J.Sh. F. Banjë Malishevë	Padi sipas Aktgjykimit P.nr.313/18	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Gjakovën-Dega në Malishevë
2	N.T.P. Krasniqi,	Padi për kompensim dëmi	
3	Y.Sh., F. Banjë Malishevë	Padi sipas Aktgjykimit P.nr.312/18	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Gjakovën-Dega në Malishevë
4	Padi ndaj ATK-së, Prishtinë	A.nr.902/2020	Gjykata Themelore në Prishtinë
5	A.nr. 1648/20, 19.11.2020	Padi për Inicimin e Konfliktit Administrativ	Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti Administrativ

PROCEDURA PËRMBARIMORE

	Prill	Maj	Qershor	Totali
NJËSIA PUNUESE PRIZREN				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	13	60	/	73
PRAPËSIME	3	/	9	12
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	3	/	9	12
MARRËVESHJE	27	5	10	42
TË PËRFUNDUARA	11	15	3	29
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	3	1	4
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	4
TËRHEQJE	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	1	1	1	3

NJËSIA PUNUESE SUHAREKË				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	/	/	/	/
PRAPËSIME	1	/	/	1
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	1	/	/	1
MARRËVESHJE	1	1	/	2
TË PËRFUNDUARA	/	1	/	1
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	/	/	1	1
NJËSIA PUNUESE MALISHEVË				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	/	/	/	/
PRAPËSIME	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	/	/	/	/
MARRËVESHJE	4	4	1	9
TË PËRFUNDUARA	/	4	/	4
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	/	1	/	1
ME PËRFAQËSUES	/	/	/	/
NJËSIA PUNUESE DRAGASH				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	/	/	/	/
PRAPËSIME	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	/	/	/	/
MARRËVESHJE	/	/	/	/
TË PËRFUNDUARA	/	1	/	1
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	/	/	/	/
LËNDËT E NGELURA PEZULL	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	/	/	/	/

PROBLEMET GJATË PROCESIT TË PUNËS

Vazhdojnë te jen problem lëndët e lartcekura të cilat e kërcënojnë Kompaninë, kemi lëndë që kanë të bëjë me kontest nga marrëdhënia e punës, lëndë që kanë të bëjnë kompensim dëmi, kontest pronësor dhe kontest lidhur me borxhin e ujit .

Gjatë procesit të punës Zyra Ligjore ballafaqohet me probleme të natyrave të ndryshme, ndër të cilat mundë ti përmendim:

Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, respektivisht Neni 360, Paragrafi 1, Nënparagrafi 1.1, e parasheh afatin njëvjeçarë të parashkrimit për ujë të pijes, me ç'rast kompanisë po i shkakton dëme të konsiderueshme materiale, pasi që gjykata në shumicën e Vendimeve të cilat po i merr po thirret pikërisht në këtë dispozitë, ndërsa kompania për këto borxhe ka qenë e ngarkuar dhe ka paguar TVSH.

Deri te përmbartimi i lëndës përmbartuesi has në probleme të ndryshme duke filluar nga gabimet në evidentimin e konsumatorëve, ku në propozim për përmbartim figuron emër tjetër, ndërsa shfrytëzues i shërbimeve të ujit është person krejt tjetër.

Mungesa e numrave personal gjithashtu ndikon në vonesa për përmbartimin e lëndëve.

Pasaktësia e adresave të vendbanimit të konsumatorëve gjithashtu ndikon në vonesa për përmbartimin e lëndëve.

Faturimi në emra të vdekurve, sjellë humbje kohe dhe probleme tjera përcjellëse, pasi që të njëjtëve duhet të ju caktohen përfaqësues të përkohshëm.

Kyçjet ilegale të konsumatorëve për kompaninë janë të kushtueshme, mirëpo Vendimet e gjykatave në aspektin e disiplinimit të konsumatorëve kanë dhënë rezultate pozitive edhe pse ato ende janë rezultate fillestare.

Rastet sociale të konsumatorëve gjithashtu na paraqesin problem, sepse neve jemi të detyruar që ti tërheqim propozimet për përmbartim kur bëhet fjalë për rastet e rënda sociale, e që shpenzimet për taksat e përmbartimit i bartë kompania.

PUNËT E REALIZUARA NGA TM PARAPRAK

Vlerësoj se Departamenti Administrativ ka bërë një përmblyllje të kënaqshme të TM1-2020, janë realizuar të gjitha obligimet ligjore të parapara në detyrat e punës si përgjegjësi kryesore dhe në statutin e Kompanisë.

Janë respektuar Politikat e Kompanisë për Procedimin për Përmbartim të Borxheve të Konsumatorëve të cilët nuk i paguajnë faturat e tyre ndaj Kompanisë për shërbimet e ofruara, për Arkëtimin e të gjitha faturave të pakontestueshme për shërbimet e ofruara.

SYNIMET E DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

Synim i Departamentit Administrativ është përcjellja dhe zbatimi i të gjitha ligjeve dhe ndryshimeve eventuale që kanë të bëjnë me funksionalizimin sa më të mirë të kompanisë.

Mbetet që në vazhdimësi të punohet në Përpilimin e rregulloreve të nevojshme, për rregullimin e politikave dhe procedurave të përgjithshme të KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh. A, duke u bazuar në nevojën për suksesin e mbarëvajtjeve të punëve në Kompani si dhe propozimeve të dala nga Menaxhmenti, Bordi i Drejtorëve dhe Aksionari-Qeveria e Republikës së Kosovës.

Përfaqësim sa më të mirë në Gjykatë dhe Institucionet kudo që do të paraqitet nevoja;

Të vazhdojmë me nxjerrjen e Akteve të reja, korrigjimet, eventuale të Akteve ekzistuese ku vërejmë se ka vend për intervenime, pastaj të bëjmë ndryshime dhe plotësime të Akteve të brendshme të Kompanisë sipas kërkesave Ligjore.

VI RAPORT I AUDITORIT TË BRENDSHËM

Përmes këtij raporti, është bërë përmbledhja dhe prezentimi i punëve dhe aktiviteteve të auditorit të brendshëm, të realizuara gjatë periudhës kohore prill - qershor 2022.

- Bazuar në planin vjetor të punës për vitin 2022, të aprovuar nga Komisioni i Auditimit, sipas planifikimit është vepruar në auditimin e proceseve, sikurse:
 - Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të deklarimit dhe pagesës të tatimit në burim dhe kontributeve pensionale;
 - Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të raportimit,
 - Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të rekrutimit të punonjësve, si dhe është në proces
 - Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të prokurimit.
 - Në pajtim me procedurat e punës dhe standardet e auditimit të brendshëm janë mbajtur takimet fillestare, takimet përmbyllëse, si dhe janë përgatitur raportet e auditimit.
 - Duke u bazuar në testimet e kryera dhe të gjeturat e auditimit, në përgjithësi është konstatuar se zhvillimi i procedurave dhe menaxhimi i proceseve, është kryer në pajtim me dispozitat ligjore, është treguar një performancë e mirë e shërbimeve, si dhe është konstatuar një funksionim i mirë i kontrollit të brendshëm.
 - Gjatë kësaj periudhe raportuese, kam qenë i angazhuar në ofrimin dhe përgatitjen e dokumentacionit të kërkuar nga auditorët e ZKA, në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të kompanisë për vitin 2021.
 - Në pajtim me ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, nr. 06/L-021, është përgatitur raporti 6 mujor për Njësinë Qëndrore Harmonizuese të MF, lidhur me auditimet e brendshme të kryera si dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për periudhën 01-06/2022.
 - Gjatë këtij tremujori, në bazë të procedurave të punës së auditimit, është përgatitur raporti i tremujorit të parë për periudhën janar – mars 2022, lidhur me aktivitetet kryesore të kryera auditorit të brendshëm.
 - Poashtu, gjatë kësaj periudhe është bërë rishikimi i adresimit të rekomandimeve të dhëna gjatë periudhës tremujore TM1/2022.
- Në vazhdim të këtij raporti, janë bashkangjitur edhe raportet e lartë përmenduar, sikurse:
- Raportet e 3 auditimeve të realizuara gjatë periudhës 03-06/2022, si dhe
 - Raporti 6 mujor i punës për NJQH/AB, për periudhën 01-06/2022.

VII. PROCEDURAT E PROKURIMIT – TM1 2022

Ky raport pasqyron punën në zyrën e prokurimit të KRU “Hidroregjioni Jugor” sh.a Prizren dhe ecuritë e procedurave për gjatë muajve Prill-Qershor, të vitit fiskal 2022.

Gjatë kësaj periudhe në zyrën e prokurimit janë zhvilluar këto aktivitete:

Këtij dokumenti i janë bashkangjitur si aneks të gjitha llojet e kontratave (me vlerë të vogël, të mesme dhe të madhe) të nënshkruara deri më sot me operatorët ekonomik si dhe procedurat që janë në përgatitje e sipër.

Titulli i kontrates	Nr.Prokurimit	Data nenshkrimite	Operatori Ekonomik	Vlerat e kontrates	Vërejtje
Furnizim, ndërrim dhe mirmbajtje e gomave të KRU Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren.	HJ-22-004-121	13.04.2022	Dyqani i pavarur tregtar Autopjese "Buqa"	47,269.67€	
Furnizim me Klor	HJ-22-005-121	07.04.2022	Seykos SHPK	26,390.00€	
LOT I Furnizim me pajisje per regjistrim te hyrjeve - daljeve LOT II Furnizim me printer per shtypjen e ID kartelave LOT III Fotoaparate digjitale+memory card per fotoaparar(8gb)	HJ-22-006-121	14.06.2022	LOT II: InterAdria L.L.C LOT III: InterAdria L.L.C	LOT I:1,810.00€ LOT II:1,450.0€	LOT I-OSHP
Furnizim me zhavor dhe pjesë Betonike.	HJ-22-007-121	06.05.2022	Eurovia SHPK	81,712.50€	
Abonimi dhe mirmbajtja e sistemit GPS per monitorimin dhe menaxhimin e automjeteve te KRU Hidroregjioni Jugor sh.a	HJ-22-008-221	05.05.2022	"TMS MOBILE" SHPK	21,760.00€	
Hapja e puseve hulumtuese dhe puseve eksploatuese per nevojat e KRU "Hidroregjioni – Jugor " Sh.A. Prizren	HJ-22-009-521				Pezulluar
Furnizim me material per zyre	HJ-22-010-121	07.06.2022	"ARF" SHPK	21,269.00€	
LOT I Furnizim me pajisje për detektimin e rrjetit të ujësjesit- matje të ujit dhe matje të thellesise së puseve . LOT II Furnizim me pajisje për nevojat e autoparkut-Servisit	HJ-22-011-121				Anuluar :15.06.2022
LOT I FURNIZIM ME PAJISJE DHE MAKINERI TË PUNËS, LOT II FURNIZIM ME VEGLA PUNE	HJ-22-012-121	15.06.2022	LOT II:FURNIZIM ME VEGLA PUNE " HPI " SH.P.K.	22,000.00€	LOT I FURNIZIM ME PAJISJE DHE MAKINERI TË PUNËS,-Anuluar
Furnizim me mobilje per zyre	HJ-22-013-136	18.05.2022	"Trendy Home" shpk	2,235.00€	
LOT I Furnizim me dy(2) server për bazën e të dhënave . LOT II Furnizim me tre(3) UPS. LOT III Furnizim me një kasetë metalike për mbrotje të kabinetit të rrjetit dhe serverëve	HJ-22-014-121		LOT I: " TMS MOBILE " SH.P.K LOT II: STORM ICT L.L.C.	LOT I:12980,00€ LOT II:2 895,00€	LOT III: Anuluar ne mungese te ofertuesve
Furnizim me lend djegese(Karburant)	HJ-22-015-136				Hapja: 17.06.2022
Furnizim me nafte	HJ-22-016-111				Ne procedur

Organogrami i KRU "Hidroregjioni Jugor", Sh. A

